MBULESA E NANË ZAHIDES, BURIM I TË MIRËS, TABAN DHE VLERË MBI VLERAT!

IDENTITETI NË KORNIZËN E ISLAMIT

DUKE KUJTUAR REVISTËN "ZANI I NALTË"

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 20 - Nr. 9 (235), Shtator, 2022

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

XHAMIA E PLUMBIT (1773)

Filloi restaurimi!

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari gjatë xhumasë së datës 9 shtator 2022 u shpreh se ky restaurim madhor është një sihariq i veçantë për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë, premtim i mbajtur nga Presidenti i Türkiye-s, Rexhep Tajjip Erdoğan, për të cilin jemi falënderues, qeverisë së tij dhe popullit vëlla turk!

TAKIME PUNE PËR FILLIMIN E FAZËS SË RE INTENSIVE TË RESTAURIMEVE NË XHAMINË E PLUMBIT

Ditën e mërkurë, më 7 shtator 2022, pranë xhamisë së Plumbit u zhvillua një takim konsultativ pune mes përfaqësuesve të institucioneve të Myftinisë Shkodër, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër (DRTKSH), e përfaqësuar nga drejtorja Besara Potgorica dhe kompanisë kontraktore turke "Kadioglu", e cila do të merret me zbatimin e projektit restaurues të xhamisë, me supervizor Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare...

(f. 16)

MYFTIU I SHKODRËS PRITI ATASHEUN PËR ÇËSHTJET FETARE NË AMBASADËN E TURKIYE-S

Të enjten paradreke, më 8 shtator 2022, në ambientet e Myftinisë Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një vizitë Dr. Adem Gerlegiz, atasheun për çështjet fetare, pranë Ambasadës së Republikës së Turkiye-s në Tiranë.

Fillimisht, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari i uroi mirëseardhjen zyrtarit turk në zyrën e Myftinisë dhe në Shqipëri gjithashtu.

Në një bisedë të ngrohtë mes tyre, Myftiu e njohu...

(f. 17)

MBULESA E NANË ZAHIDES,
BURIM I TË MIRËS, TABAN DHE VLERË MBI VLERAT!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Natyrshëm një sihariq shumë i madh për të gjithë muslimanët shqiptarë, e ata të Shkodrës në veçanti, është dhe ky lajm i gëzueshëm dhe i mbarë, i cili na vjen sot si një përmbyllje të një amaneti të shenjtë dhe të shtrenjtë, të cilin e dëgjuam këtu e disa muaj më përpara në Ankara nga goja e Presidentit të Turkisë, Rexhep Tajip Erdoğan, i cili premtoi se qeveria e tij do të restaurojë xhaminë e Plumbit dhe ishte pikërisht ajo ditë dita e parë e fillimeve të punimeve për restaurimin e xhamisë tonë shekullore, sepse kur burrat e mëdhenj e japin fjalën ata e mbajnë atë!

Të gjitha falënderimet e plota dhe Madhështia absolute i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm të Gjithësisë. Atë e falënderojmë që na bëri prej muslimanëve dhe urdhëroi në Kur'anin Famëlartë se, herë pas here Allahu i Madhëruar i gëzon zemrat e besimtarëve me sihariqet e Tij.

Natyrshëm një sihariq shumë i madh për të gjithë muslimanët shqiptarë, e ata të Shkodrës në veçanti, është dhe ky lajm i gëzueshëm dhe i mbarë, i cili na vjen sot si përmbyllje e një amaneti të shenjtë dhe të shtrenjtë, të cilin e dëgjuam këtu e disa muaj më përpara në Ankara nga goja e Presidentit të Turkisë, Rexhep Tajip Erdoğan, i cili premtoi se qeveria e tij do të restaurojë xhaminë e Plumbit dhe ishte pikërisht ajo ditë, dita e parë e fillimit të punimeve për restaurimin e xhamisë tonë shekullore! Sepse, kur burrat e mëdhenj e japin fjalën, ata e mbajnë atë!

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Të gjitha salavatet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë e në çdo moment të jetës sonë, më të mirit e më të shtrenjtit, Hazreti Muhammedit (a.s), i cili na udhëzon nëpërmjet shembullit të tij praktik se, *ndërtimi i xhamisë ka një simbolikë të shtrenjtë te myslimanët për gjatë të gjithë historisë së tyre. Pa xhami nuk mund të ketë funksionim normal të jetës së besimtarëve.* Ne shqiptarët e këtyre trojeve të ngushta e pamë më së miri pas vitit 1967 deri në 1990, se çfarë do të thotë të jetosh pa xhami?! Çfarë do të thotë i syrgjynosur në tokën, në besimin e në lirinë tënde!? Desht Allahu i Madhëruar pas shumë përpjekjesh, e pas shumë angazhimesh nga ata burra të mirë e të sinqertë, e nga ato nëna shamibardha, të vinte ajo ditë fatlume e 16 nëntorit 1990, që u kthye në një Bajram të Madh mbi çdo bajram tjetër për shqiptarët! Ajo ditë e madhe dhe ai sinjal hyjnor nëpërmjet të cilit, Zoti i Gjithësisë na tha të gjithëve se e sotmja, e djeshmja dhe e ardhmja janë pa tjetër të lidhura pas besimit dhe pas forcës së Tij në zemrat e njerëzve të sinqertë! E, nga ajo ditë e deri më sot, kanë kaluar mbi tre dekada, dhe ajo çfarë duhet të shohë gjithsecili nga ne, në pasqyrën e kësaj ngjarjeje të madhe dhe kësaj simbolike të shtrenjtë, është se ku ndodhemi ne dhe ku jemi sot, në marrëdhënien që kemi me besimin tonë dhe fetarizmin e shëndoshë?

Sot, gëzohemi se është e xhumaja e fundit, thonë shokët e mi dhe kolegët e Myftinisë! Xhumaja e fundit në xhaminë e Plumbit!?

Unë them: Jo!

Sot, është e xhumaja më e bukur, pas asaj xhumaje të shtrenjtë të 16 nëntorit 1990. Sepse do të mbyllet kjo derë, për t'u rihapur më me dinjitet dhe plot krenari dhe nam e nishan, siç i takon xhamisë së Plumbit, xhami e ndërtuar me duar të pastra të myslimanëve të devotshëm shkodranë, xhami e cila i ka rezistuar për shekuj furtunave dhe përmbytjeve, të gjitha pabesive dhe pusive, të papriturave dhe të pallogaritura.

Sot, falë Zotit të Gjithësisë po na bahet nasib të jemi dëshmitarë të kësaj dite të madhe dhe këtij momenti historik për secilin prej nesh, për të thënë: Allahume lekel-hamd (O Zot, Ty të takon falënderimi), që erdhi kjo ditë e begatë dhe ta përhajrojmë njëri-tjetrin. Duke dalë nga xhamia e Plumbit të themi se ritakohemi këtu (inshallah) pas një viti, por jo më në këtë xhami në këtë gjendje, por në një xhami siç i takon xhamive shekullore për t'u shërbyer, siç Allahu (xh.sh) thotë në Kur'anin Famëlartë: "Ata që i ndërtojnë, i mirëmbajnë xhamitë e Allahut janë besimtarë dhe besojnë në jetën e përtejme!"

Islamofobët dhe osmanofobët e trojeve tona shqiptare, që ka kohë, që ditë pas dite, e moment pas momenti, nuk rreshtin së hedhuri vrer kundër Islamit e muslimanëve. Nga ata që janë veshur me petkun e politikës, e deri tek ata që janë veshur me petkun e akademizmës, deri tek ata që janë veshur qoftë edhe me petkun e fesë, që flasin e flasin këto ditë kundër hixhabit! Ne që për fat të keq e kemi nënkryetar të parlamentit tonë, thotë se "mbulesa e vajzave tona i shërben agjendës serbe!"

Nuk mundet asesi që hixhabi i Nanë Zahides me i shërby agjendave serbe! Nuk mundet assesi që hixhabi i nënave tona që na mëkuan për Allahun dhe dashninë për tokën e dashninë për njëri – tjetrin, e t'i shohim të gjithë krijesat e Zotit si vëllezër, myslimanë e të krishterë, me fe e pa fe. Nuk mundet që hixhabi i tyre t'i shërbejë asnjë axhendeje të keqe! Nuk mundet! Sepse, hixhabi simbolizon më të mirën e vlerave, e dijes e të përkushtimit, të familjes e të gruas së pastër e të ndershme!

Nuk mundet asesi që hixhabi i Nanë Zahides me i shërby agjendave serbe! Nuk mundet as sesi që hixhabi i nënave tona që na mëkuan për Allahun dhe dashninë për tokën e dashninë për njëri – tjetrin, e t'i shohim të gjithë

krijesat e Zotit si vëllezër, myslimanë e të krishterë, me fe e pa fe. Nuk mundet që hixhabi i tyre t'i shërbejë asnjë axhendeje të keqe! Nuk mundet! Sepse, hixhabi simbolizon më të mirën e vlerave, e dijes e të përkushtimit, të familjes e të gruas së pastër e të ndershme!

Simbolika e harmonisë e vëllazërisë në mesin tonë nuk mund të jetë asnjë herë shërbyese e axhendave, që siç thotë fatkeqësisht një person anonim, na i shërbeka axhendave serbe!?

Ekstremi politik, kur fut hundët në çështjet e fesë apo keqpërdor fenë, kthehet në një rrezik kombëtar dhe në një kazëm që përpiqet ditë-natë për të shkatërruar harmoninë kombëtare dhe harmoninë ndërfetare në mesin tonë! Duhet t'i dalim përballë e t'i themi të heshtin, të heshtin dhe të merren me punët e veta, sepse ti dhe sojsorollopi yt nuk jeni të thirrur për të futur hundët aty ku nuk duhet për të prishur normat, etikën dhe vlerat e harmonisë tonë kombëtare dhe ndërfetare!

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Për të mos e prishur këtë ditë gëzimi, por që gjithsesi për të ndenjur me këmbë në tokë dhe për të qëndruar me dinjitet përballë çdo sfide dhe përballë çdokujt nga çdo lloj foltoreje që të jetë, kemi për detyrë që ta përhajrojmë njëri-tjetrin dhe të themi me zemër se ajo çfarë Zoti i Gjithësisë na urdhëron në Kur'anin Famëlartë: "Mos u dëshpëroni, mos u dobësoni sepse ju jeni ngadhënjimtarë dhe triumfues, sepse jeni në hak (në të drejtën tuaj), nëse jeni besimtarë!", është thirrja më e mirë që na vjen sot, për të qëndruar besnikë në këtë fé të pastër e të shtrenjtë islame. Është një thirrje për të parë veten në pasqyrë dhe për të thënë: O Zot ku kemi gabuar! Që taborrat e femohimit, e islamofobisë, e osmanofobisë, janë ngritur kundër nesh dhe çështjeve tona islame!

A nuk është momenti për t'u kthyer, a nuk është momenti për të parë në pasqyrë dhe për të parë se si i kemi marrëdhëniet me hixhabin në veçanti me namazin, me namusin, me etikën islame në shtëpitë tona, në marrëdhënie që kemi me bashkëqytetarët tanë të feve të tjera, në qytetin tonë e kudo që jetojmë?!

Teksa falim këtë të xhuma të bekuar në xhaminë e Plumbit t'i japim besën Allahut (xh.sh), me zemër e me shpirt, për t'i thënë me sy të mbyllur e me zemër të drejtuar nga Qabja jonë e shtrenjtë: "Lebbejkallahumme lebbejk", për hixhabin e grave dhe nënave e motrave e bijave tona. "Lebbejkallahumme lebbejk" për të qëndruar në besën tënde e për të mos shkuar pas thirrjeve të atyre që janë përgjigjur dikujt tjetër dhe nuk kanë thënë "Lebbejkallahumme lebbejk", por janë përgjigjur dikujt tjetër përveç Allahut.

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Ne kemi nevojë për doza të mirësisë, për doza të thirrjes islame në jetën tonë për të jetuar me dinjitet dhe krenari dhe për të mos e kthyer kokën asnjëherë pas, ku ishim para se të vinte 16 nëntori! Për të mos kthyer kokën pas nga haramet, nga shthurja morale nga devijimi nga imoraliteti nga gënjeshtra nga afetarizmi nga dashakeqësia dhe përçarja në mes vëllezërve. Por për të jetuar në harmoni dhe dashamirësi me njëri-tjetrin si vëllezër të një toke, si vëllezër të një besimi, aty ku është besimi si vëllezër të sa e sa interesave të përbashkëta, për hir të së cilave duhet të qëndrojmë të gjithë së bashku përpara çdo sfide dhe përpara çdokujt që na do të përçarë!

Diktoi tekstin: **Siditë Hafizi**

Teksa falim këtë xhuma të bekuar në xhaminë e Plumbit t'i japim besën Allahut (xh.sh), me zemër e me shpirt, për t'i thënë me sy të mbyllur e me zemër të drejtuar nga Qabja jonë e shtrenjtë: "Lebbejke Allahumme lebbejk", për hixhabin e grave dhe nënave e motrave e bijave tona. "Lebbejke Allahumme lebbejk" për të qëndruar në besën tënde e për të mos shkuar pas thirrjeve të atyre që janë përgjigjur dikujt tjetër dhe nuk kanë thënë "Lebbejke Allahumme lebbejk", por janë përgjigjur dikujt tjetër përveç Allahut.

Dr. Salahudin Ahmed Keftaro

"Sa shumë kemi nevojë ne muslimanët të kuptojmë si duhet fenë tonë, pas asaj që dëshmuam, prej akuzave devijuese ndaj nesh me ekstremizëm dhe terrorizëm, si rezultat i komploteve të armiqve të ymetit, keqkuptimit tonë të vlerave tona dhe moslartësimit të udhëheqësve dhe dijetarëve tanë në gradën e bartjes së amanetit!

Arabët dhe muslimanët mbetën pas popujve të tjerë, prandaj duhet medoemos të ketë një rizgjim intelektual, rilindje ekonomike dhe mbrojtje të fisnikërisë njerëzore të popujve mbarë, për të qenë të gjithë, dorë për dore drejt një të ardhmeje premtuese më të mirë!"

(Nga arabishtja: Muhamed B. Sytari)

VLERA E BASHKËPUNIMIT NË ISLAM

Naim Drijaj
Imam - Xhamia Parrucë

Njeriu është urdhëruar që të gjitha porositë e Allahut t'i zbatojë jo vetëm për veten e tij, por edhe të ndihmojë dhe bashkëpunojë me të tjerët për t'i realizuar dhe kryer ato në formën më të mirë dhe më të plotë.

Allahu i Madhëruar thotë: Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!"[1]

Abdurrahman Es-Sadi në tefisrin e tij duke e komentuar këtë ajet thotë: Allahu i Lartësuar na urdhëron që të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin për dy qëllime:

Së pari, për bamirësi (El-Birr). El-Birr është një term përfshirës i gjithçkaje, që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, qoftë vepër e dukshme apo e padukshme, që ka të bëjë me plotësimin e të drejtave të Allahut apo me të drejtat e krijesave.

Së dyti, për devotshmëri (takva), fjalë e cila përfshin në këtë ajet gjithçka që duhet lënë e braktisur, qoftë vepër e dukshme apo e padukshme, që është e urryer prej Allahut të Lartësuar. Çdo punë të mirë, të cilën Allahu e do dhe është i kënaqur me të, dhe çdo vepër të keqe të cilën Ai e urren, Ai e ka sqaruar tërësisht nëpërmjet Librit të Tij dhe Profetit.

Njeriu është urdhëruar që të gjitha porositë e Allahut t'i zbatojë jo vetëm për veten e tij, por edhe të ndihmojë dhe bashkëpunojë me të tjerët për t'i realizuar dhe kryer ato në formën më të mirë dhe më të plotë. Besimtarët duhet të ndihmohen dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të zbatuar porositë e Zotit dhe të Profetit të Tij në çdo mënyrë të lejuar dhe të mundshme: Me fjalë nxitëse apo me vepra që ngjallin optimizëm dhe ambicie.

Et-Takva devotshmëria nënkupton veprimin e asaj, që Allahu ka urdhëruar dhe braktisjen e asaj që Allahu ka ndaluar.[2]

"...dhe mos e ndihmoni njëri tjetrin në gjynahe e armiqësi!" Allahu i Lartësuar na ndalon që të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë tjetrin për të kryer vepra të ulëta dhe të ndaluara, që e ngarkojnë njeriun me gjynahe dhe e çojnë atë drejt ndëshkimit. Gjithashtu, Ai na ndalon nga armiqësia dhe padrejtësia ndaj krijesave, duke cenuar jetën, pasurinë dhe nderin e tyre. Kështu, robi duhet ta ndalojë veten prej harameve dhe padrejtësive, por duhet të ndihmoj edhe të tjerët për t'iu larguar atyre.[3]

Imam Kurtubiu në tefisrin e tij duke e komentuar këtë ajet thotë: Ky ajet është urdhër për mbarë krijesat që të bashkëpunojnë në të mira dhe devotshmëri, të ndihmojnë njëri tjetrin, për t'i zbatuar urdhrat e Allahut dhe për tu larguar nga ndalesat që ka ndaluar Ai, kjo është në përputhje me hadithin e Pejgamberit (a.s): Ai që udhëzon drejtë së mirës, është sikur ai që e vepron atë.[45]

Bashkëpunimi në mirësi dhe devotshmëri mund të ndodhë në disa forma, si (p.sh) obligimi i dijetarit është që të ndihmojë njerëzit me dijen e tij duke i mësuar ata, i pasuri të ndihmojë njerëzit me pasurinë e tij e kështu me radhë. Kurse bashkëpunimi i ndaluar është bashkëpunimi në gjynahe e armiqësi, siç është ndihmesa në derdhjen e gjakut të dikujt, grabitjen e pasurisë së dikujt, nëpërkëmbjen e nderit të dikujt, etj.[6]

Dijetarët e Islamit kanë lënë porosi të çmuara në këtë drejtim. Një nga dijetarët e Islamit kur fletë për ndihmën dhe bashkëpunimin mes njëri-tjetrit thotë: Në qoftë se nuk e shikon vëllanë tënd besimtar për tre ditë rresht atëherë kërkoje duke bërë çdo përpjekje në mënyrë që ta gjesh atë, sepse ai mund të jetë i sëmurë dhe ka nevojë që të vizitohet, mund të jetë i zënë me punë e ka nevojë të ndihmohet, ose është habitur (është i angazhuar me punët e kësaj bote) dhe ka nevojë që t'i përkujtohet situata në të cilën ai ndodhet. Allahu i Madhëruar thotë: "Bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira".[7]

Pejgamberi (a.s) na ka mësuar rrugët se si muslimani mund të veprojë vepra të mira.

1. Edhe një fjalë e mirë është sadaka.[8]

2. Buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd musliman është sadaka.[9]

3. Mbrohuni nga zjarri i xhehenemit qoftë edhe me një gjysmë hurme.[10]

4. Ebu Dherri (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s) o i Dërguari i Allahut më trego një vepër, që nëse e veproj do të fitoj me të xhenetin. Profeti (a.s) i është përgjigjur: Besimi në Allahun.

Ebu Dherri (r.a) pyeti? Besimi a lyp vepra?

Pejgamberi (a.s) i tha: Të japë nga pasuria që i ka dhënë Zoti.

Ebu Dherri pyeti: Po nëse njeriu është i varfër?

Profeti (a.s) i tha:Të flasë një fjalë të mirë më gjuhen e tij.

Ebu Dherri pyeti: Po nëse personi është memec pa gojë?

- Të ndihmojë një person të cilit i është bërë zullum (padrejtësi).

Ebu Dherri pyeti: Po nëse personi është i dobët dhe nuk ka force që ta ndihmojë atë?

- Të ndihmojë të paaftin në punën e tij.

Ebu Dherri pyeti: Po nëse personi është i paaftë?

Pastaj Pejgamberi (a.s) i tha Ebu Dherrit a nuk do t'i lësh asnjë mundësi njeriut për të bërë mirë? Nëse muslimani nuk ka mundësi për të bërë mirë të pakten keq të mos bëjë".[11]

Disa shkaqe që e shtyjnë besimtarin

1. Kur'ani, El-Maide: 2.
2. Mexhmau El-Fetava, 3/120.
3. Tefsir Sadi, 2/238.
4. Transmetuar nga Muslimi.
5. Tefsir Kurtubi, 3/6/33.
6. Tefsir Kurtubi, 6/ 47.
7. Kur'ani, El-Bekare: 148.
8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
9. Transmetuar nga Tirmidhiu.
10. Transmetuar nga Buhariu.
11. Transmetuar nga Bejhakiu në Shuabul-Iman.

për të bashkëpunuar.

1- Zbatimi i urdhrit të Allahut që përmendet në ajet.

2- Shtimi i shpërblimit dhe shumëfishimi i tij. Besimtarët kanë dobi nga veprat e njëri-tjetrit, të cilat i praktikojnë, siç është namazi me xhemat, secilit besimtar i shtohet shpërblimi deri në njëzet e shtatë fish, për shkak të pjesëmarrjes së të tjerëve në namaz. Pra, vepra e të tjerëve është shkak që të shtohet shpërblimi, ashtu sikurse vepra e tij është shkak për t'iu shtuar shpërblimi të tjerëve.

3- Nevoja. Duke pasur parasysh që njeriu është një krijesë e dobët gjithmonë ka nevojë për bashkëpunim dhe përkrahje.

4- Realizimi dhe përsosja e punës. Bashkëpunimi me të tjerët në një punë e bën më të lehtë realizimin e saj.

- Më shumë se në tetëdhjetë vende në Kuran, Allahu i Madhëruar na drejtohet me thirrjen: "O ju që keni besuar". Shumica e obligimeve në Islam janë bërë në thirrjen shumës e jo njëjës.

P.sh, për agjërimin Zoti (xh.sh) na drejtohet në mënyrë kolektive, por secili këtë obligim e kryen në mënyrë individuale. Kur punët kryhen në mënyrë kolektive bëhen më të lehta.

- Më shumë se në njëzet thirrje në Kuran Allahu (xh.sh) na drejtohet me fjalët: "O ju njerëz". Me këto fjalë, Ai i drejtohet të gjithë njerëzimit pa dallim feje, kombi, race, gjuhe, etj.

- Allahu i Madhëruar në disa ajete në Kuran na drejtohet edhe në bazën e përbashkët të origjinës njerëzore: "O bijtë e Ademit".

Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin edhe sëmundjet, fatkeqësitë, hallet, borxhet, etj tejkalohen më lehtë.

Disa arsye që e pengojnë bashkëpunimin me njëri-tjetrin:

1. Marrja e disa shembujve të dështuar. P.sh, një person merr borxh dhe e keqpërdor atë. Mos lejo që përvojat e këqija të njerëzve të të pengojnë nga bashkëpunimi me të tjerët.

2. Egoizmi.

3. Zilia/Inati. Zili do të thotë të urresh arritjen e një begatie apo të mire tek të tjerët dhe të shpresosh që ajo begati apo e mirë të largohet nga ata. Zilia qe ajo vepër, e cila e shtyu njërin prej bijve të Ademit, drejt vrasjes së vëllait tjetër.

Zilia është penguesi më i madh i bashkëpunimit!

EDEBI I QËNDRIMIT NË XHAMI

Mustafë Bajrami, *teolog (Prishtinë)*

Një dukuri e shëmtuar që ka marrë dhenë tek shqiptarët e sidomos në Shqipëri, është mungesa e edebit të uljes në xhami. Ditëve të xhuma teksa hoxha tregon va'az apo mbanë hytben, xhemati (e çuditërisht të rinjtë më shumë se sa të moshuarit), shtrijnë e hapin këmbët sikur të ishin ulur në livadh. Mbështeten në duar prapa, në mure e në direkët e xhamisë si të ishin dërguar me dhunë aty. Nuk di nëse imamët ua tërheqin vërejtjen këtyre njerëzve. Nuk di nëse ju është thënë se në xhami nuk shkohet as me t-shirt me mbishkrime sepse i pengon të tjerët. Imamët e kanë për detyrë tu flasin njerëzve. E nëse paraqitet nevoja, tu bëhet me gisht atyre që ulën në atë mënyrë dhe të tjerëve që flasin tema dynjallëku teksa hoxha është duke mbajtur va'az. Me patjetër këtë duhet ta bëjnë imamët e xhamive tona.

Nuk është keq të shkruhet 'Kodi i Mirësjelljes' dhe të varet në hyrje apo brenda xhamive.

Shtëpitë e Zotit respektohen edhe me mënyrën e uljes në to, edhe me mënyrën e veshjes kur shkon aty, e natyrisht, edhe me mirëmbajtjen e oborreve të xhamive. (Kam parë xhami nëpër fshatra ku bari është rritë deri në shokë dhe askush nuk e kositë).

Njerëz të mirë!

Është edeb islam të ulesh para mihrabit e para hoxhës në mënyrë të kulturuar. Jo të shtrihen këmbët e të hapen sikur që bënë në plazh. Mbase është e turpshme dhe reflekton edukatën familjare. Aq më tepër kjo tregon mungesën e edebit që e porositë Resulullahi a.s....!

P/S: *Për hir të xhematit, këtu nuk do të postoj foto për të parë shëmtinë e uljes së paedukuar nëpër xhamitë tona...!*



IDENTITETI NË KORNIZËN E ISLAMIT

Msc. Zamira Bushati, *teologe*
Vaize - Myftinia Shkodër

Sot ndodhemi në një kohë, ku shumë shoqëri po vuajnë nga kriza e identitetit. Avazi i zhvlerësimit të identitetit vetëm sa vjen e shtohet, ndërsa shumë vlera dhe virtyte po humbasin kuptimin real të tyre. Edhe pse për krizën e identitetit flitet që në shekullin e njëzet, ky trend vazhdon edhe sot, thjesht për shkak se shumë aspekte të identitetit janë subjekt për t'u ndryshuar, humbur, fituar, mbajtur dhe ruajtur.[1]

Por, për sa kohë nuk e kemi të qartë se çfarë identiteti mbartim, ekziston rreziku i humbjes dhe mos ekzistencës sonë sepse njeriu e përkufizon veten dhe e pozicion atë përmes identitetit.

Por çfarë kuptimi ka fjala identitet? Në fjalorin e gjuhës shqipe, identitet do të thotë: "Të qenit i veçantë nga të tjerët dhe i njëjtë vetëm me veten në disa veçori e tipare që shërbejnë për t'u njohur pa vështirësi si i tillë, të qenët po ai.[2]

Pra, identitet do te thotë se kush je, është tërësi e të gjitha karakteristikave të individit në çfarëdo rrethane. Ai është shprehje e qenësisë së individit, e përkufizon atë se si individi e sheh veten dhe përfaq veçantinë e tij. Për një shoqëri identiteti është tërësia e karakteristikave që e veçon atë dhe e bën të dalluar nga të tjerat. Prandaj me anë të identitetit çdonjëri nga ne përcakton se kush është, çfarë do jetë, përcakton vlerat që i përkasin dhe që diktojnë në vendimet dhe veprimet e tij.[3]

Çfarë do të thotë identitet islam?

Identiteti islam do të thotë: të besosh dhe të aderosh në fenë islame, duke qenë krenar për përkatësinë ndaj saj, si dhe të respektosh vlerat civilizuese dhe tradicionale të saj, të shfaqësh dhe t'i përmbahesh simboleve islame. Identiteti islam formësohet përmes pastërtisë se shpalljes dhe shprehet në shembullin më të arrirë njerëzor, atë të Profetit, (a.s).

Ky identitet është në harmoni me natyrën njerëzore. Ai nuk është thjesht pohim, por program gjithëpërfshirës. Skema e tij është hartuar që nga zanafilla e krijimit, e cila kristalizohet me nënshtrimin dhe bindjen ndaj Allahut. E detyra e të gjithë Profetëve ka pasur si qëllim rishqyrtimin dhe fuqizimin e këtij identiteti[4].

Elementët përbërës të identitetit janë: feja, mendimi, kombësia, gjuha, historia, kultura, etj. P.sh. mund të themi për një vajzë, shqiptare, muslimane, besimtare, studente, shkodrane, etj. Të gjitha këto janë elemente përbërës, që tregojmë për identitetin e kësaj vajze. Ndërsa format apo mënyrat e paraqitjes së identitetit janë ato që lidhen me zakonet, stilin e veshjes, etikën e një individi.

Sipas Islamit, elementët e identitetit janë te obliguara nga Zoti, me qëllim që t'i përmbahemi. Ndërsa format apo mënyrat e identitetit janë të deleguara nga Zoti, e mund të ndryshojnë nga njëri individ te tjetri, por duhen të jenë brenda kornizave të moralit.[5]

Tiparet kryesore të identitetit islam janë:

Besimi islam. Historia, e cila ruan elementet dhe ngjarjet e saj, duke qëndruar në rrugën e duhur dhe duke përfituar prej saj në aspekte të ndryshme të jetës dhe marrëdhënieve njerëzore.

Kultura, e cila është një strukturë njohurish e shkencave, vlerave, etiketave, gjuhës, arritjeve shkencore dhe civilizuese të shoqërisë dhe përfitimeve të saj në të njëjtin model dhe drejtim, d.m.th. çfarë fiton nga vlerat, rregullat dhe kulturat në ndërveprimin e saj me shoqëritë e tjera. Kultura është fleksibël dhe e aftë për t'u zgjeruar, ajo nuk është statike.

Morali/Etika: Është një shtyllë bazë e identitetit personal e kombëtar dhe një synim i madh për mesazhet qiellore.

Tipari dallues i identitetit islam ose komponenti më i rëndësishëm i tij, është besimi, i cili ndërthur jo vetëm besimin në një Zot të Vetëm, por duhet të shoqërohet me veprimet dhe sjelljen, qoftë në nivelin individual apo në nivel grupor/shoqëror. Prandaj formimi dhe realizimi i identitetit islam si në planin individual, ashtu edhe në atë social para së gjithash është e lidhur me besimin në Njëshmërinë e Zotit, e cila jo vetëm që është pikënisja e identitetit, por e bën njeriun anëtar të bashkësisë së besimtarëve muslimanë.

Për këtë arsye, gjëja e parë që është përcaktuar dhe shpallur është "Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë"[6] Që do të thotë se, aty ku nuk gjendet besimi në njëshmërinë e Zotit, nuk mund të bëhet fjalë për një individualitet islam. Para së gjithash dhe në mënyrë të veçantë është e rëndësishme dhe e nevojshme që ta mbajmë gjallë në zemra besimin në njësinë e Zotit së bashku me të gjithë veçoritë karakteristike që e dallojnë atë.

Ky identitet është në harmoni me natyrën njerëzore. Ai nuk është thjesht pohim, por program gjithëpërfshirës. Skema e tij është hartuar që nga zanafilla e krijimit, e cila kristalizohet me nënshtrimin dhe bindjen ndaj Allahut. E detyra e të gjithë Profetëve ka pasur si qëllim rishqyrtimin dhe fuqizimin e këtij identiteti

Ky tipar dallues jetësohet duke u kapur fort pas litarit të Allahut. Prandaj principi bazë që do të mundësojë ruajtjen e identitetit islam është Kurani (Libri hyjnor) dhe sunneti (tradita profetike) si ftilluese e kuptimit të Kuranit. Ky princip theksohet qartë në ajetin kuranor "Të gjithë mbahuni fort mbas litarit të Allahut (Kuranit) dhe mos u përçani!"[7] Nga ku kuptohet se dinamizmi dhe vazhdimësia e identitetit islam mund të

1. Shih; Mr.sc. Jusufi, Azmir, Identiteti yt është krenaria jote, https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=11404
2. www.fjale.al
3. Kajan, Ramazan; Ndërtimi i identitetit nën hijen e shpalljes; Furkan; Shkup, 2016, f. 10.
4. Shih, po aty, f. 10
5. Po aty.
6. Kur'ani, En-Nisa: 36.
7. Kur'ani, Ali Imran: 103.

arrihet vetëm duke u kapur pas litarit të Allahut, në sajë të komentit me traditën profetike, sepse nuk mund ta rrokësh diçka dhe të kapesh fort pas tij, pa e njohur dhe kuptuar mirë më parë atë.

Në traditën profetike është skicuar dhe ilustruar në planin universal, rruga që të shpie drejt të kuptuarit të mësimeve të Kuranit dhe të jetuarit në përputhje me to, sepse është Profeti Muhammed (a.s), ai që ua kumtoi Kuranin muslimanëve dhe që ua komentoi atë. Allahu e urdhëroi profetin Muhammed që të shpallte haptazi këtë të vërtetë: "Thuaju o Muhammed! Po qe se ju e doni Allahun, atëherë më pasoni mua."[8]

Edhe vetë profeti Muhammed e ka bërë të qartë personalisht me këto fjalë, faktin që ruajtja e identitetit dhe vijës së mësimeve islame është e mundur vetëm në sajë të përqafimit pa rezerva të librit të Allahut dhe traditës së tij, kur është shprehur se: "Po ju lë pas dy gjëra. Për sa kohë që do të kapeni fort pas tyre nuk do të shmangeni nga udha e drejtë. Ato janë libri i Zotit dhe praktika ime profetike."

Po të ndalemi me kujdes në ajetin e mësipërm "Të gjithë mbahuni fort mbas litarit të Allahut (Kuranit) dhe mos u përçani!"[9] Fjala "të gjithë", tregon se është kusht rruga e mbrojtjes dhe ruajtjes së identitetit islam në shkallë bashkësie fetare. Prandaj në Islam, të gjitha kategoritë e shoqërisë nga ato më të ulëtat deri tek ato më të lartat, janë të obliguara, që të kapen fort pas litarit të Allahut. Në të është e varur edhe vitaliteti i bashkësisë muslimane.

Identiteti islam, do të mund të realizohet duke u kapur të gjithë në masë, si ymet, pas librit të Allahut, gjithashtu duke ndjekur traditën profetike (sunetin) dhe duke mos rënë në krijimin e grupacioneve kundërshtare me njëra-tjetrën brenda muslimanëve. Kjo është rruga e vetme me të cilën shoqëria muslimane mund të ruajë vetveten ndaj çdo lloj presioni kulturor, ekonomik, politik, etj.

Shpeshherë, në jetën e përditshme përballemi me disa reagime e komente, të cilat na ftojnë që besimin tonë ta shfaqin dhe ta praktikojmë pjesërisht, si iu pëlqen apo iu përshtatet disa njerëzve. E nëse mundohemi t'i përmbahemi Islamit na drejtohen duke na thënë se nuk jemi në arabi këtu, këto janë sjellje apo tradita arabe, etj. Por ata harrojnë apo bëjnë sikur harrojnë se identiteti islam nuk është vetëm për arabët, por është për të gjithë muslimanët që kanë përqafuar Islamin në mbarë botën, në cilindo skaj të saj, çfarëdo kombësie apo race mbartin. Kjo sepse karakteristikat/tiparet e identitetit islam nuk janë zgjedhur nga ndonjë njeri apo për ndonjë racë të veçantë; nuk janë zgjedhuir nga një grup njerëzish apo nga disa individë të veçantë, por ata janë zgjedhur dhe përcaktuar për ne nga vetë Allahu xh.sh., i cili në suren Bekare thotë:

"(Thoni) Kjo fe është "ngjyra" që na ka dhënë Allahu! S'ka "ngjyrë" më të bukur se ajo që jep Allahu! Ne vetëm atë adhurojmë!" [10]

Në këtë ajet, Allahu (xh.sh) e qartëson se muslimanët duhet që të ndjekin "ngjyrën" apo identitetin fetar që Ai ka zgjedhur për ta dhe duhen t'i përmbahen atij.

Prandaj, ne si muslimanë nuk duhet të kemi turp apo të tregohemi indiferentë ndaj besimit që mbartim, apo ndaj zbatimit të tij në jetën e përditshme dhe para njerëzve, sepse ky besim dhe ky identitet që kemi është në harmoni me natyrën njerëzore dhe në përputhshmëri me vullnetin e Allahut. Me anë të këtij identiteti ne kuptojmë jetën njerëzore në linjën e shpalljes hyjnore dhe realizojmë qëllimin e krijimit tonë, atë të "mëkëmbësit të Zotit" në tokë.

Gjithashtu duhet ta kemi të qartë se pa shfaqur identitetin dhe përkatësinë tonë në shoqëri, nuk mund të kryejmë rolin e ndikimit në qytetërimin njerëzor. E nëse bëhemi imitues të verbër të qytetërimeve të tjera nuk mund të kemi një shkallë të lartë të zhvillimit shpirtëror, shoqëror, kulturor e material, por do tjetërsohemi dhe do të asimilohemi shumë shpejt.

Atëherë, na del si detyrë që të njohim mirë kuptimin që mbart identiteti në përgjithësi dhe identiteti islam në veçanti; të mirëinformohemi rreth problematikave tona që lidhen me jetën e përditshme, të përpiqemi t'i japim zgjidhje çështjeve në atë mënyrë që nuk do t'i dëmtonte vlerat themelore islame, të mos shkojmë pas debateve që nuk japin zgjidhje reale dhe konkrete, të ruajmë përherë vlerat e mëdha e t'i mbrojmë ato, të mos bëhemi imitues të të tjerëve ...

Vetëm kështu mund të realizohet detyra jonë në këtë botë, detyra e mëkëmbësit, të jemi mbartësit e qartësisë së vlerave islame, të jemi ndjekës të shembullit të Pejgamberit (a.s) në epokën tonë, dhe të rrugëtojmë drejt arritjes së kënaqësisë së Zotit!

8. Kur'ani, Al Imran: 31.
9. Kur'ani, Ali Imran: 103.
10. Kurani, El-Bekare: 138.

Shejkh Jusuf El-Karadavi
(9.9.1926 - 26.9.2022)

NGUSHËLLIM!

"Të Allahut jemi
dhe tek Ai do të kthehemi!"

Me dorëzim të plotë para kaderit të Allahut, Myftinia Shkodër lajmëron opinionin e gjerë publik, se sot, më 26 shtator 2022, në Doha, Katar, ndërroi jetë dijetari i shquar islam dhe muxhtehidi i kohës:

Hirësia e Tij,
Shejkh Jusuf El-Karadavi

Ndarja nga jeta e këtij kolosi të shquar të dijeve islame dhe e një muxhtehidi të nivelit të tij, ka shkaktuar një dhimbje të madhe në mbarë botën islame, anëmbanë globit tonë.

Me qindra mesazhe ngushëllimi nga krerët më të lartë të botës islame, shprehin ngushëllimet drejtuar YMETIT ISLAM, me rastin e kësaj humbjeje të pazëvendësueshme!

Me këtë rast, Myftinia Shkodër dhe Myftiu i saj, Imam Muhamed B. Sytari, shprehin ngushëllimet më të thella për mbarë muslimanët e botës me rastin e largimit nga bota e përkohëshme e dijetarit dhe kolosit të shquar islam, Shejkh Jusuf El-Karadavi.

"Të Allahut jemi
dhe tek Ai do të kthehemi!"

DUKE KUJTUAR REVISTËN "ZANI I NALTË"

Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Botimi prej 10 vëllimesh i Kolanës "Zani i Naltë", organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, i themeluar më 1923, përfshin vite botimi 1923 – 1939. Kjo revistë e çmueshme për 16 vite rresht përmes fjalës së bukur e të mençur shqipe është përballur me realitetin e atyre viteve dhe nuk është gjunjëzuar.

Kjo revistë fatlumësisht fatlume, sepse, diti të mblidhte rreth vetes Burra të ditur e të 'Naltë'; me një problematike të gjerë, të larmishme fetare dhe atdhetare, multidisiplinare, pasqyroi realitetin e atyre viteve në të shumtën e rasteve të pakëndshme e dramatike; me kualitete të larta teologjike, shkencore e kulturore.

Në faqet e saj dimensioni i mendimit shkëlqente vrulltas. Temat interesante që trajtoheshin, kishin gjerësi dhe thellësi. Konceptet artikuloheshin dhe zbërtheheshin drejt. Diversiteti i mendimit ishin tribunë e njohur. Argumenti – bazë e dialogut. Filozofia – e pranishme. Trajtesat kishin shpirtin e devotshëm dhe guximin krijues. Modele shkrimesh, modele rrëfimesh, modele ligjërimesh. Leksik i pasur. Sintaksë e pasur. Kulturologji. Ndaj, u paraqit realisht tabloja e rrugës së Islamit, e myslimanëve nëpër rrjedhat e kohës. Koha me diakroninë e sinkroninë e saj e pranishme gjithëherë. Koha me diakroninë e sinkroninë e saj merrej model dhe shembëlltyrë.

Morali, socialiteti, kombëtarja shfaqeshin përmes rreshtave e poezisë të shoqëruar me këshilla e urti islame, me urtinë e Dijetarëve Islamë. Ja, pse në shkrimet e saj të vyera të kësaj reviste të vyer mori dimensionin e vërtetë fjala: 'INTELEKTUAL'. Kjo është dhe arsyeja që shikimi i saj ishte i vërtetë, pa hile, i ndershëm dhe vizionar. Kjo është arsyeja që triumfoi mbi sfidat keqdashëse, mbi furtunat e kohës, mbi vranësirën e motive të liga. Qe një revistë që sillte diellin e mendimit dhe shpresën e besimit, i jepte udhë ëndrrës dhe të nesërmes së jetës. Nderim e nderuara Revistë që në vetvete mbart një simbolikë të qëlluar, kuptimplote, universale, me hapësira vlerash dhe dinjitet njeriu.

Revistë që në platformën tënde ruajte të shtrenjtë e të paprekur palcën e Shqiptarizmës e më gjerë. Nuk e tradhtove. Iu fale. E nderove! Dhe kishe të drejtë në rrugën tënde rrugëdrejtë. Sepse këtë mision ishin disa burra Zënaltë që e kishin marrë si amanet. Dhe ishin emrat e nderuar, si: Ismail Maçi, Shyqyri Myftiu, Isa Domni. Haki Sharofi. Por ishin dhe kontributet e pafund të të Diturve, si: Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Ali Korça, Jonuz Bulaj, Haki Sharofi, Ferit Vokopola, etj., që dritësuan dhe hijeshuan faqe çdo faqe të kësaj reviste me kontribut të pashembullt. Revistë që nuk kishte frikë, revistë që kishte dinjitet.

Dhe erdhi një ditë që kjo revistë të mos ndjehej e braktisur a të rrinte e heshtur në rafte, apo si relike thjeshtë për t'u përmendur a shikuar si në një pavijon muzeu. Apo "të zgjohej" dhe "të jetonte" vetëm kur të zgjatet vetëm dora e një studiuesi. Doemos, ajo që udhëtoi e dritëshme për 16 vjet, nuk mund të rrinte e heshtur në kohë. Ajo, me misionin e saj kishte ofruar kohërat, i kishte ndritur dhe, kohërat nuk mund t'i rrinin larg, ta harronin përmes heshtjes. Kohërat duhej ta nderonin dhe e nderuan…

Botimi në një kolanë prej 10 vëllimesh është një akt fisnik, besimdashës, kulturor, qytetërues e civilizues. Dhe falënderimi shkon për botuesit: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë.

Shkodër, më, 07.09.2022



BIOLOGIA GJERMANE: NJERIU NGA ANA SHKENCORE: O MASHKULL, OSE FEMËR!

Biologia gjermane: Njeriu nga ana shkencore: O mashkull, ose femër!

Biologia gjermane Christiane Nüsslein-Volhard, fituese e çmimit Nobel në vitin 1995, tha se, njeriu në aspektin shkencor është ose meshkull ose vetëm femër, dhe gjithçka tjetër, që thuhet ndryshe është "marrëzi".

Në një intervistë për revistën gjermane (Emma), ajo shtoi se në rastin e njeriut, si gjitar që është, ekziston një seks që prodhon vezën dhe quhet femra, dhe ka një seks që prodhon spermën dhe quhet mashkulli.

e saj të ngjirur dhe flokët e mjekrës mund t'i rriten, por kjo nuk do të çonte në zhvillimin e testikujve që prodhojnë spermë.

Shkencëtarja gjermane theksoi se t'u japësh njerëzve lirinë për të përcaktuar gjininë e tyre që nga mosha 14 vjeç është "çmenduri", duke vënë në dukje se shumica e vajzave, duke përfshirë edhe atë personalisht, nuk ndihen të lumtura në atë moshë dhe dëshirojnë të ishin djem, sepse kjo do t'u jepte atyre më shumë liri për të bërë gjëra, që vajzat nuk mund t'i bëjnë.

Ajo tha se kushtet sociale dhe

Biologia gjermane Christiane Nüsslein-Volhard, fituese e çmimit Nobel në vitin 1995, tha se, njeriu në aspektin shkencor është ose meshkull ose vetëm femër, dhe gjithçka tjetër, që thuhet ndryshe është "marrëzi".

Ajo sqaroi se, edhe në rastin e organizmave biseksualë që mund të prodhojnë vezë dhe spermë, ata duhet të çiftëzohen me një kafshë tjetër të së njëjtës specie, në mënyrë që realizohet procesi i riprodhimit. Në të gjitha rastet, ka një vezë dhe ka një spermë, pra dy gjini!

Christiane tha se injektimi i një femre me hormone mashkullore, për shembull, ndoshta mund t'ia bëjë zërin psikologjike ndoshta mund të ndikojnë në ndjenjat dhe dëshirat e njeriut, por ato nuk e ndryshojnë realitetin biologjik.

Christiane ndau Çmimin Nobel në Fiziologji dhe Mjekësi në vitin 1995 me dy amerikanët, Eric Wieschaus dhe Edward Lewis, për kërkimet e tyre mbi mekanizmat e zhvillimit të embrionit dhe mundësinë e kontrollit gjenetik.

(Burimi: Al Jazeera Mubasher)



Shejkh Muhamed El-Gazali

"

Liria nuk është e drejtë e njeriut të kthehet në bagëti nëse do, apo të mohojë përkatësinë e tij shpirtërore nga Zoti i botëve, apo të punojë vepra që dobësojnë lidhjen e tij me qiellin dhe forcojnë lidhjet e tij me dheun. Liria me këtë kuptim, nuk është më tepër se përmbysje e të vërtetave dhe largim i sendeve nga origjina e tyre e palëkundshme!

Madje, realiteti është se ti nuk do të gjesh më adhurues dhe më të nënshtruar, se sa një person i cili pretendon se ai është i lirë, dhe kur hulumton për gjendjen e tij, do ta shohësh se ai është i poshtëruar ndaj të gjitha epsheve të tij.

Ndoshta është skllav i barkut dhe i seksit; ndoshta është skllav i paraqitjes së jashtme me të cilën mburret përpara njerëzve, ose i protokolleve zyrtare, që i mendon se janë personaliteti i tij.

E, nëse humbet disa prej këtyre dëshirave, do ta shohësh se është gjëja më e pavlerë, edhe sikur të ketë postin më të lartë, madje edhe nëse është mbret, ku njerëzit i përkulen!"

(Nga libri Kadhaiful-Hak)

IRANI
OSE REPUBLIKA ISLAMIKE E IRANIT

Irani, ose zyrtarisht Republika Islamike e Iranit, është një vend në Azinë Perëndimore. Ai kufizohet me Armeninë, Azerbajxhanin, Turkmenistanin dhe Detin Kaspik në veri, me Afganistanin dhe Pakistanin në lindje, me Gjirin Persik dhe Gjirin e Omanit në jug, dhe me Turqinë e Irakun në perëndim. Irani gjithashtu kontrollon rreth një duzinë ishuj në Gjirin Persik. Rreth një e treta e kufirit të tij (prej 7680 km) është bregdet.

Irani mbulon një sipërfaqe prej 1.648.195 km², duke e bërë atë vendin e katërt më të madh në Azi, dhe vendin e dytë më të madh në Azinë Perëndimore, pas Arabisë Saudite.

Irani ka një popullsi prej 86.402.560 milionë banorësh *(shtator, 2022, sipas worldometers.info)*, duke e bërë atë vendin e 17-të më të populluar në botë.

Qytetet më të mëdha janë kryeqyteti Teherani, pastaj qytetet Mashhad, Isfahan, Karaxh, Shiraz dhe Tabriz.

Kryeqyteti i vendit është **Teherani**.

RELIEVI

Irani përbëhet kryesisht nga zona të thyera malore, të cilat zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes së vendit. Pellgu qendror i vendit përbëhet nga shkretëtira të gjera dhe nga male. Irani ka fusha të vogla dhe jo të vazhdueshme. Për sa i përket topografisë, Irani mund të ndahet në 4 rajone kryesore:

1. Rajoni i Malësisë Perëndimore, që ndodhet në veri të Gjirit Arab, midis kufijve të Irakut dhe maleve të Zagrosit. Ky është rajoni që përfshin fushat e naftës, dhe konsiderohet një zonë e rëndësishme bujqësore gjithashtu.

2. Malësitë Veriore: Pjesa më e madhe e rrafshnaltës së brendshme kufizohet nga dy zinxhirë të mëdhenj malorë, të cilët formojnë një mur të madh ndarës mes rajonit të Bregut Kaspik dhe rrafshnaltës së brendshme. Dy zinxhirët malorë janë: vargmali i Elborzit, i cili ndodhet në kufijtë veriorë të Iranit, dhe vargmalet e Zagrosit, që shtrihen në jug dhe në lindje të kufijve me Turqinë dhe Ish-Federatën Sovjetike, drejt Gjirit. Pjesa jugore e Iranit është shumë e thatë dhe e përthyer. Vargmale më të vogla shtrihen përgjatë Gjirit të Omanit dhe kufijve me Afganistanin dhe Pakistanin.

3. Rajoni i Malësive Lindore: Ky rajon karakterizohet nga varfëria ekstreme, pasi mbulohet nga zhavorri dhe dunat ranore. Klima e këtij rajoni karakterizohet gjithashtu nga ekstreme të ashpra, dhe shpesh është i ekspozuar ndaj erërave të forta. Prandaj, ky rajon karakterizohet nga një ekonomi e varfër dhe nga popullsia e pakët.

4. Rrafshnalta e Brendshme (qendrore), e cila ndodhet në qendër të Iranit dhe në perëndim të tij. Ajo zë afërsisht gjysmën e sipërfaqes së Iranit, dhe është e rrethuar nga malet. Ky rajon pasi në zonat malore në veriperëndim, temperaturat janë të ulëta, dhe dimri është i gjatë dhe i ashpër, kurse vera është e moderuar. Në të kundërt të kësaj, gjejmë se vera në fushat e Khuzestanit, në jugperëndim, është jashtëzakonisht e nxehtë dhe e lagësht, kurse dimri është i moderuar, i butë. Klima e rrafshnaltës së brendshme është shumë e thatë, dhe temperaturat në dimër, në tokat shkretinore, zbresin deri në ngrirje. Kurse, sa i përket bregut të detit Kaspik, ai ka temperatura të moderuara në verë,

përfshin shkretëtirën e madhe të Kripës, dhe shkretëtirën e Lutit.

Pika më e ulët në vend shënohet në detin Kaspik, që zbret në 28 metra nën nivelin e detit. Pika më e lartë e vendit shënohet në majën Damavand, me 5671 metra mbi nivelin e detit. Lumi më i gjatë i vendit është Lumi Karun, 950 km (i vetmi lum i lundrueshëm). Liqeni më i madh në Iran është Liqeni Urmia, me sipërfaqe 4.868 km², dhe ishulli më i madh i vendit është Ishulli Keshm, me një sipërfaqe 1491 m².

KLIMA

Klima e Iranit në përgjithësi mund të përshkruhet si e thatë ose gjysmë e thatë. Ajo ndryshon nga një rajon në tjetrin, dhe shira të dendura në stinët e vjeshtës dhe të dimrit.

EKONOMIA

Ekonomia e Iranit është e treta më e madhe në Lindjen e Mesme dhe e njëzet e nënta në botë, me një vëllim prej 337.9 miliardë dollarësh (viti 2010). Ekonomia e Iranit varet kryesisht nga eksporti i naftës dhe i gazit.

Rreth 20% e tokës në Iran është e punueshme. Zonat kryesore të prodhimit të ushqimit ndodhen në brigjet e Detit Kaspik dhe në luginat e veriperëndimit të vendit.

Gruri është kultura më e rëndësishme dhe kultivohet në perëndim dhe

Kryeqyteti, Teheran

veriperëndim të vendit. Orizi është kultura kryesore në rajonin e detit Kaspik. Irani prodhon gjithashtu elb, misër, pambuk, çaj, kërp, duhan, fruta (përfshirë agrumet), patate, bishtajore (fasule dhe thjerrëza), perime, bimë foragjere (jonxhë), erëza (përfshirë kamunën, sumakun dhe shafranin (prodhuesi më i madh në botë)), dhe arrore (fistikët (prodhuesi më i madh në botë), bajamet dhe arrat).

Irani zotëron 10% të rezervave të provuara të naftës, në botë, dhe është anëtar i Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC), që prodhon 4 milionë fuçi në ditë, ku më shumë se gjysma e tyre eksportohet jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër shkon për konsum të brendshëm.

Rezervat e gazit natyror të Iranit vlerësohen në 29.61 trilion metra kub, që përbëjnë 15% të rezervave botërore të gazit. Irani eksporton gaz në Turqi nëpërmjet tubacionit Tabriz-Ankara, dhe në Armeni nëpërmjet një tubacioni që lidh Armeninë me Iranin, siç importon gaz nga Turkmenistani nëpërmjet tubacionit Doulet Abād-Sarkhas-Khankiran.

GJUHA

Shumica e popullsisë flet persisht, e cila është edhe gjuha zyrtare e vendit. Në vend fliten edhe gjuhë të tjera, që u përkasin disa etnive të ndryshme që jetojnë në Iran, si gjuhët Gilaki, Mazenderani, Talysh, varietete të kurdishtes, gjuhët Luri dhe Lari, gjuha azerbajxhanase, si dhe disa gjuhë dhe dialekte të tjera turke, që fliten në rajone të ndryshme të Iranit, veçanërisht në rajonin pranë Azerbajxhanit.

Gjuhët e shquara të pakicave në Iran përfshijnë edhe armenishten, gjeorgjishten, neo-aramaishten dhe arabishten. Arabishtja Khuzi flitet nga arabët në Khuzestan, si dhe nga komuniteti më i gjerë i arabëve iranianë. Çerkezishtja dikur flitej gjerësisht nga minoriteti çerkez, por, për shkak të asimilimit përgjatë viteve, kjo gjuhë flitet nga një numër i pakët çerkezësh.

Përqindjet e dhëna nga CIA's World Factbook, tregojnë se 53% e popullsisë flasin persishten, 16% azerbajxhanasen, 10% kurdishten, 7% mazenderani dhe gilaki, 7% luri, 2% turkmenishten, 2% balochi, 2% arabishten dhe 2% pjesa tjetër armene, gjeorgjiane, neo-arameike dhe çerkeze.

Sheshi Naksh Xhahan, Asfahan

FEJA

Shumica e iranianëve (rreth 99%) janë muslimanë, ku pjesa më e madhe e tyre ndjekin sektin Shi'a Xha'feri, i njohur gjithashtu si medhhebi Imamij, ose medhhebi i Dymbëdhjetëve. Pastaj, në vend të dytë për nga numri i ndjekësve vjen medhhebi Sunit. Gjithashtu, në vend gjenden edhe komunitetet të feve të tjera, si të krishterë, bahaj, hebrenj dhe zoroastrianë.

HISTORI

Irani gëzon një histori të pasur, që shtrihet me disa mijëra vite më parë. Kjo histori mund të ndahet në tri epoka: Epoka antike para-islame (559 p.e.s- 651 e.j); Epoka islame (651 - 1800 e.j); dhe epoka moderne, që fillon me takimi e Iranit me perëndimin, rreth vitit 1800.

Epoka antike para-islame: Historia e vërtetë 'iraniane' fillon me migrimin e fiseve iraniane nga Azia Qendrore, në atë që tani njihet si "Rrafshnalta

12

Iraniane", në mijëvjeçarin e 2-të, para erës sonë. Por, vendbanimet e organizuara njerëzore u zhvilluan shumë më herët, dhe qytetërimi Elami, në Iranin jugperëndimor – Iraku jugor sot – u shfaq në mijëvjeçarin e 3-të p.e.s. Nga mijëvjeçari i parë p.e.s, u shfaqën dy shtete të dallueshme iraniane, në formën e Medëve dhe Persëve, dhe hyrja e tyre e theksuar në skenën botërore filloi në vitin 559 p.e.s ,me ardhjen e Kirit II.

Perandoria perse e Akaemenidëve u bë perandoria më e madhe në tokë, e njohur deri atëherë nga njerëzimi, me administratën e saj relativisht dashamirëse, dhe e cila mbështetej në idetë fetare, që më vonë do të lidheshin me Zoroastrianizmin, fenë para-islame të Iranit, dhe që bazohej në parimin "fjalë të mira, mendime të mira, dhe vepra të mira". Rreth 150 vjet më vonë, në vitet 330 p.e.s, vendi ra në duart e Aleksandrit të Madh, dhe sundimi helen zgjati atje një shekull, deri në ardhjen e një dinastie të re iraniane nga lindja: Dinastia Partiane.

Perandoria partiane e riformoi historinë iraniane, duke importuar mite dhe legjenda nga lindja, dhe duke zëvendësuar Akaemenidët në kujtesën popullore. Kjo mbretëri e decentralizuar – në të cilën mbreti ishte i pari mes të barabartëve, mbreti i mbretërve - e kompensoi përçarjen e saj me jetëgjatësi (është më e gjata nga të gjitha dinastitë iraniane), dhe u tregua një armik serioz i perandorisë romake që po formohej, duke i shkaktuar asaj një nga disfatat e saj më të mëdha. Kjo ndodhi në fushat Karrhae, në vitin 53 p.e.s, ku komandanti romak Crassus (i famshëm për disfatën që i shkaktoi Spartakut) u mund në mënyrë vendimtare nga një forcë më e vogël partiane, e përbërë kryesisht nga harkëtarët me kuaj, duke i shkaktuar atij humbjen e rreth dy të tretave të legjioneve të tij, si edhe disa 'shqiponja' (standarde romake).

Pas 500 vjetësh, në vitin 224 e.j, partianët u përmbysën nga një dinasti tjetër, e cila këtë herë vinte nga vetë tokat e zemrës së Persisë, dinastia Sasane.

Sasanët ishin padyshim trashëgimtarët e partianëve, por perandoria e tyre ishte më e centralizuar dhe "mbreti i mbretërve" ishte më shumë se 'i pari mes të barabartëve'. Administrata ishte konsoliduar, dhe Zoroastrianizmi u promovua si besimi zyrtar dhe gjithnjë e më i mirëpërcaktuar. Me kalimin e kohës, mbretërit sasanianë, veçanërisht Khusrau II, do të simbolizonin gjithçka që ishte e mirë për Iranin para-islam dhe administratën e tij. Ashtu si paraardhësit e tyre, sasanët u treguan kundërshtarë të fortë të perandorisë romake dhe më pas bizantine, duke u përfshirë në një cikël konfliktesh me ta.

Në shekullin e 7-të, një fuqi e re doli nga gadishulli Arabik: Islami. Duke mposhtur bizantinët, ushtritë arabe muslimane përfundimisht e pushtuan dhe e përthithën perandorinë sasaniane në Kalifatin e ri. Islami e transformoi botëkuptimin iranian, dhe prej tyre dolën dijetarë të mëdhenj muslimanë.

SI ERDHI ISLAMI NË IRAN

Takimi i Iranit me Islamin filloi gjatë epokës së Ebu Bekr Es-Siddikut - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - kur Muthenne Ibn Harithe, në vitin 13 hixhrij, arriti të merrte disa toka të Iranit, ngjitur me zonën e jugut të Irakut.

Gjatë epokës së Omerit - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - Ebu Ubejd Eth-Thakafi - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - u përpoq të sulmonte Iranin nga jugperëndimi, dhe u ndesh me Persianët në Betejën e Urës, në vitin 13 hixhrij. Allahu bëri të mundur mposhtjen e zjarrputistëve (iranianë), pastaj Ebu Ubejd marshoi për në Kaskar, ku u ndesh me Nursiun dhe e mundi atë, pastaj u ndesh me Galinusin dhe e mundi edhe atë. Pastaj u erdhi radha muslimanëve, nga të cilët u vranë dhe u mbytën një numër i madh prej tyre, në mesin e të cilëve edhe Ebu Ubejd - Allahu qoftë i kënaqur prej tij!" - (Sijer E'alām En-Nubela', 2/421)

Pastaj muslimanët vazhduan përpjekjet për marrjen e Iranit, nën udhëheqjen e Sa'd ibn Ebi Vakasit - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - në vitin 14 hixhrij, ku ushtria muslimane u shkaktoi një disfatë të rëndë persëve në betejën e Kadisijes, e cila ishte një nga betejat e mëdha të muslimanëve.

***

Para se të fillonte lufta mes tyre, Rustemi, prijësi i persianëve, i kërkoi Sa'ad ibn Ebi Vekasit - Allahu qoftë i kënaqur prej tij - t'i dërgonte një nga njerëzit e tij të bisedonte me të, dhe Sa'adi (r.a) zgjodhi për të një luan nga luanët e tij, Rabia ibn Amir - Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Para se Rabia të mbërrinte tek Rustemi, ky i fundit përdori metodën e tundimit. Kështu që, e zbukuruan ambientin ku do të rrinin me jastekë e gjëra të zbukuruara me perla, rubin dhe gurë të çmuar. Megjithatë, ata u befasuan nga një burrë me shtat të shkurtër, i veshur me rroba të vrazhda, që mbante armë të thjeshta dhe i cili erdhi hipur mbi një kalë të vogël.



Kompleksi Amir Chakhmak - Jazd

Rabia - Allahu qoftë i kënaqur prej tij – vazhdoi të qëndronte hipur mbi kalë, derisa shkeli mbi sendet e tyre të mëndafshta... pastaj zbriti nga kali dhe e lidhi atë me një copë mëndafshi që e grisi. Rabia iu drejtua Rustemit t'i afrohej, dhe rojat i thanë të hiqte armët, e ai u tha: "Unë nuk erdha tek ju me kërkesën time, por më ftuat ju. Prandaj, nëse më lini të vazhdoj kështu siç jam, pranoj, përndryshe kthehem.". Atëherë Rustemi i tha: "Çfarë ju solli?".

Dhe Rabia - Allahu qoftë i kënaqur prej tij – tha: "Zoti na ka dërguar ne, që ta nxjerrim kë të dojë Ai, nga adhurimi i robërve në adhurimin e Zotit të robërve... dhe nga ngushtësia e kësaj bote, në gjerësinë e kësaj bote dhe të botës tjetër – Ahiretit... dhe nga padrejtësia e feve, në drejtësinë e Islamit. Kështu që, Zoti na dërgoi me fenë e Tij, për ta përcjellë atë tek krijesat e Tij, që t'i ftojmë ata për tek Ai. Dhe kush nuk pranon, ne e pranojmë prej tij haraçin... e nëse ai refuzon, do ta luftojmë derisa të fitojmë. Rustemi i tha: "Ndoshta vdisni para se të ndodhë kjo.". Rabia tha: "Zoti na premtoi se kush prej nesh vdes në këtë rrugë, i takon xheneti, kurse kush mbetet i gjallë, i takon fitorja.".

Rustemi i tha: "Unë i dëgjova fjalët e tua, prandaj, a na jep afat derisa të marrim mendimin e prijësve dhe njerëzve tanë?".

Rabia i tha: "Po, të jap afat një ose dy ditë?". Rustemi i tha: "Jo, më jep më shumë, sepse do të bisedoj me njerëzit e mi nëpër qytete!". Rabíai tha: "I Dërguari i Zotit na ka urdhëruar që të mos u japim afat armiqve tanë, në rast lufte me ta, më shumë se tri ditë, kështu që unë po të jap tri ditë afat, dhe pas këtij afati zgjidh një nga tri alternativat: Ose Islamin, dhe nuk të luftojmë ty... ose haraçin, e nëse ke nevojë për ndihmën tonë ne të ndihmojmë ty... ose luftën në ditën e katërt. Dhe unë të garantoj ty, në emër të popullit tim, se ne nuk do të fillojmë t'ju luftojmë deri në ditën e katërt, përveç nëse filloni ju."

Rustemi i tha: "Zotëria i tyre je ti?". Rabíai i tha: "Jo, unë jam një burrë nga ushtria, por më të ulëtit prej nesh, i respektohet fjala që jep, nga më të lartët."

Rustemi foli përsëri me njerëzit e tij të afërt, dhe u tha: "A e patë arsyetimin e tij? A e patë forcën e tij?! A e patë besimin e tij?!" ... Ai u foli kështu njerëzve të tij, që t'i bënte ata të anonin nga paqja me muslimanët, e kështu ta shmangte luftën me ta, por ata nuk pranuan dhe i thanë: "Ti ke frikë."



Porta e parkut kombëtar, Teheran

Historianët përmendin se muslimanët ishin nga shtatë deri në tetë mijë, dhe se Rustemi, udhëheqësi i Persianëve, kishte rreth gjashtëdhjetë mijë ushtarë.

"Dhe ditën e Hënë të muajit Muharrem, të vitit të 14-të (hixhrij), fryu një erë e fortë, e cila i nxori nga vendi çadrat e persëve, dhe shtratin e Rustemit që ishte ndërtuar kastile për të, e hodhi tej. Kështu që ai nxitoi të hipte në mushkën e tij dhe u largua, por muslimanët e kapën dhe e vranë. Ata vranë edhe Galinus-in, prijësin e pararojës persiane, dhe kështu persianët u mundën - falënderuar Zotit!

Muslimanët e ndoqën nga pas pjesën e mbetur të ushtrisë, dhe atë ushtarët persianë që ishin lidhur me zinxhirë për të treguar vendosmërinë e tyre në luftë, u vranë në tërësi... Në këtë ditë, dhe në ditët para saj, nga mesi i muslimanëve u vranë dy mijë e pesëqind ushtarë, Zoti i mëshiroftë!

Myslimanët i morën pas vetes një pjesë të ushtarëve të mundur persianë, derisa hynë në qytetin e Mbretit, në Persi, ku ndodhej selia mbretërore persiane." - (El-Bidaje Ven-Nihaje, 9/630).

Pastaj muslimanët vazhduan përparimin e tyre në tokat iraniane, dhe mundën të merrnin pjesën jugore të Iranit, ndërsa mbreti i tyre Jezdexhrid II, u tërhoq në rajonin e Isfahanit, në Iranin qendror, dhe filloi të mblidhte ushtarë në përpjekje për të rimarrë atë çfarë kishte humbur. Muslimanët dhe ushtarët e Jezdexhrid-it u takuan në betejën e Xheleula'-së, në vitin 18 hixhrij, betejë e cila përfundoi me disfatën e Jezdexhridit dhe ushtrisë së tij, dhe me tërheqjen e tyre drejt Isfahanit.

Pastaj Jezdexhridi u ndesh me muslimanët në betejën e Nahavendit, në vitin 21 hixhrij, ku muslimanët fituan një fitore të qartë, dhe sasanidët nuk mundën të ngrihen më në këmbë pas saj...

Ibn Kethiri - Allahu e mëshiroftë - ka thënë për këtë betejë: " Ajo është një ngjarje shumë e madhe, që ka një domethënie të madhe dhe një lajm mahnitës. Muslimanët e quanin atë fitore: "Fitorja e fitoreve". - (El-Bidaje Ven-Nihaje, 10/111).

Marrja nën kontroll e të gjitha tokave iraniane nga muslimanët zgjati gati dhjetë vite, për shkak të gjerësisë së madhe të vendit dhe përthyerjes së relievit të tij.

Një gjë tjetër që kontribuoi shumë në përhapjen e Islamit në Iran ishte emigrimi i shumë fiseve arabe në tokat iraniane, vendosja e tyre atje, dhe përzierja e tyre me iranianët.

Irani vazhdoi për gati nëntë shekuj të mbetej ndjekës i medhhebit-shkollës Sunite, derisa shteti shi'it safavid mori kontrollin mbi të, në vitin 906 hixhrij.

***

Persia i ka dhënë botës islame një numër të madh dijetarësh të shquar, nga të cilët mund të përmendim dijetarin e shquar të shkencs së Hadithit Profetik, Imam Muslimin, i lindur në Nisabur, provincë në verilindje të Iranit të sotëm. Ky është autor i librit të famshëm "Sahih Muslim".

Gjithashtu, përmendim dijetarin tjetër të shquar të Hadithit Profetik, Ibn Maxhe El-Kazvini, i lindur në Kazvin, në veri të Iranit, vepra e të cilit "Sunen Ibn Maxhe", njihet si një nga gjashtë veprat më të rëndësishme të fushës së Hadithit Profetik.

Dijetarë të tjerë të shquar të Persisë së atëhershëm dhe Iranit të sotëm, ose me prejardhje nga atje, janë El-Xhuvejni (i njohur si imami i Dy Vendeve të Shenjta, dhe dijetar i teologjisë dhe i komentimit të Kuranit), El-Begaviu (dijetar i komentimit të Kuranit famëlartë), Sibevejhi (dijetar në fushën e gjuhës), Ibn Hazmi (dijetar i shkencës së fikhut), e shumë të tjerë...

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
https://ar.wikipedia.org
https://www.britannica.com
https://www.marefa.org
https://islamqa.info/ar
https://www.historyextra.com
https://raseef22.net
https://www.worldometers.info
https://islamstory.com/ar

TAKIME PUNE PËR FILLIMIN E FAZËS SË RE INTENSIVE TË RESTAURIMEVE NË XHAMINË E PLUMBIT

Të mërkurën më 7 shtator 2022, pranë xhamisë së Plumbit u zhvillua një takim konsultativ pune mes përfaqësuesve të institucioneve të Myftinisë Shkodër, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër (DRTKSH), e përfaqësuar nga drejtorja Besara Potgorica dhe kompanisë kontraktore turke "Kadioglu", e cila do të merret me zbatimin e projektit restaurues të xhamisë, me supervizor Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare.

Përfaqësuesit e Myftinisë, teologët Arben Halluni dhe Lavdrim Hamja si dhe menaxheri i vakfit-pronave, Blendi Alushi falënderuan institucionet turke dhe shqiptare për përkushtimin dhe angazhimin e tyre maksimal për të avancuar në projektin e shumëpritur nga besimtarët e zonës, të qytetit dhe përtej tij. Ata shprehen gatishmërinë e institucionit të Myftinisë Shkodër, për të ndihmuar së bashku me institucionet shtetërore në zgjidhjen e çdo lloj problematike, që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij projekti madhor.

Në tatim u diskutuan hapat e reja dhe procedurat e zbatimit intensiv të projektit të madh restaurues dhe sistemit mbrojtës nga përmbytjet e xhamisë së Plumbit, që pritet të fillojë të xhumanë, më 9 shtator 2022, ku dhe pritet të jetë prezente Ministrija e Kulturës së Shqipërisë, Elva Margariti dhe të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari.



Kujtojmë, se nënshkrimi zyrtar i marrëveshjes në mes qeverisë shqiptare dhe qeverinë e turke për restaurimin e Xhamisë së Plumbit në Shkodër, një xhami historike dhe monument kulture i kategorisë së parë, është zhvilluar në Ankara, në janar të vitit 2021 në prani të Presidentit Erdogan dhe kryeministrit Rama, gjatë vizitës së këtij të fundit me disa ministra në kryeqytetin e Turkiye-s.

MYFTIU I SHKODRËS PRITI ATASHEUN PËR ÇËSHTJET FETARE NË AMBASADËN E TURKIYE-S, TIRANË

Të enjten paradreke, më 8 shtator 2022, në ambientet e Myftinisë Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një vizitë Dr. Adem Gerlegiz, atasheun për çështjet fetare, pranë Ambasadës së Republikës së Turkiye-s në Tiranë.

Fillimisht, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari i uroi mirëseardhjen zyrtarit turk në zyrën e Myftinisë dhe në Shqipëri gjithashtu.

Në një bisedë të ngrohtë mes tyre, Myftiu e njohu mysafirin me jetën fetare dhe aktivitetet e institucionit që ai drejton, me objektivat dhe arritjet në vite.

Gjatë këtij takimi të ngrohtë, u shkëmbyen urime dhe ide për thellimin e bashkëpunimit në rang institucional midis tyre, kryesisht në literaturë, dërgim të hafizëve turk në zonën e Shkodrës për të shërbyer në periudha të ndryshme pranë xhamive të qytetit, etj.

Të dy titullarët vlerësuan miqësinë dhe vëllazërinë tradicionale mes dy vendeve dhe rëndësinë e forcimit të saj nëpërmjet zgjerimit dhe thellimit të marrëdhënieve.

Vizita u mbyll me falënderimin e atasheut turk për pritjen vëllazërore nga Myftiu së bashku me stafin e tij.

FILLON RESTAURIMI I XHAMISË SË PLUMBIT NË SHKODËR, MYFTIU FALËNDERON PRESIDENTIN ERDOĞAN

Në Shkodër ka nisur intensivisht puna për restaurimin e Xhamisë së Plumbit, monument kulture i kategorisë së parë, me mbështetjen financiare të Türkiye-s, pas marrëveshjes së nënshkruar mes dy vendeve, shqiptare-turke.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari gjatë xhumasë së datës 9 shtator 2022 u shpreh se ky restaurim madhor është një sihariq i madh për Shkodrën dhe mbarë Shqipërinë, premtim i mbajtur nga Presidenti i Türkiye-s, Rexhep Tajjip Erdogan, për të cilin jemi falënderues atij, qeverisë së tij dhe popullit vëlla turk.

Myftiu Sytari gjatë hytbes së xhumasë, iu përgjigj edhe n/kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me debatin për shaminë e vajzave në shkolla në Kosovë duke hedhur poshtë pretendimet se shamia islame i shërben qarqeve serbe dhe i bëri thirrje atij dhe të gjithë politikanëve të tjerë që të heshtin.

"Ekstremizmi politik për fat të keq kur futë hundët në çështjet e fesë apo keqpërdorë fenë kthehet në një rrezik kombëtar dhe një kazëm që përpiqet ditë e natë për të shkatërruar harmoninë kombëtare dhe harmoninë ndërfetare në mes nesh…", ka cituar në mes të tjerave Myftiu.

Ndërkaq, ndërhyrja kryesore pritet të zgjidhë problemin e përmbytjeve, krijimin e një sistemi kullimi të sigurt, pengimin e ujërave vërshuese dhe restaurimin e e objektit. Mjedisi përreth saj do të kthehet në një park të denjë për besimtarët e turistët.

Xhamia, e cila mbart vlera të rralla arkitekturore në vend, do të restaurohet me mbështetjen financiare të Drejtorë së Përgjithshme të Vakëfeve të Türkiye-s, në kuadër të protokollit të nënshkruar në Ankara mes dy vendeve.

Xhamia është ndërtuar nga Mehmet Pashë Bushati në vitin 1773-1774, duke shërbyer për një kohë të gjatë si xhamia më e madhe e Shqipërisë.

Të dhënat tregojnë se xhamia u ndërtua me gurë të sjellë prej popullit me sistem zinxhir (dorë më dorë) prej Gurit të Zi, dhe me tepricat u ndërtuan këmbët e urës së Kirit.

Në vitin 1948 Xhamia e Plumbit u shpall monument kulture, duke pasur statusin e mbrojtjes nga shteti.

Në vitin 1967, kur edhe zyrtarisht u ndalua feja në Shqipëri, xhamia pësoi dëmtime, sidomos me rrënimin e minares, ndërkohë në periudha të ndryshme ajo nuk është përdorur zyrtarisht për kryerjen e riteve.

Ajo mbetet një xhami simbol në Shqipëri, pasi rihapi dyert për besimtarët muslimanë më 16 nëntor të vitit 1990 pas ndalimit shumëvjeçar të fesë në Shqipëri gjatë periudhës famëkeqe të komunizmit.

MYFTIU I SHKODRËS: “MUSLIMANËT SHQIPTARË NË ZVICËR, AMBASADORË TË VLERAVE TË BESIMIT!”

Me ftesë të Qendrës Kulturore Islame në Wintenthur të Zvicrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në aktivitetet e larmishme të organizuara nga kjo qendër islame, në datat 24-25 shtator 2022.

Në mbrëmjen e paharruar të mbledhjes së fondeve për projektin e xhamisë së re qendrore, mbrëmjen e së shtunës, më 24 shtator 2022, në një atmosferë besimi, vëllazërie dhe bamirësie të dëshmuar, Myftiu Sytari falënderoi organizatorin për ftesën bujare dhe këtë arritje historike për mbarë bashkësinë islame shqiptare në Zvicër.

Në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës foli për vlerën e madhe të xhamisë në jetën e muslimanëve, për kontributin e madh të shqiptarëve në ndërtimin e qendrave islame bashkëkohore në perëndim, si dhe vlerën e madhe që ka kontributi për ndërtimin e një shtëpie të re prej Shtëpive të Allahut në tokë!

Myftiu i Shkodrës mori pjesë edhe në ceremoninë e gurthemelit të xhamisë së re të shqiptarëve në Wintenthur, që u organizua të dielën, më 25 shtator 2022, në mesin e besimtarëve, autoriteteve vendore, myftilerëve të trevave shqiptare, imamëve të xhamive shqiptare të Zvicrës dhe miqve të shumtë.

Gjatë kësaj vizite në Zvicër, Myftiu u takua edhe me shumë prej imamëve, studiuesve dhe thirrësve islamë të shquar shqiptarë, që veprojnë me plot përkushtim në Zvicër e Gjermani, si dhe me myftilerët e nderuar të Bujanocit, Tetovës, Gostivarit, Strugës, etj.

TAKIM I KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE, PJESËMARRËS EDHE NGA MYFTINIA SHKODËR

Ditën e hënë, më 26 shtator 2022, Bashkia e Shkodrës, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri organizoi takimin për anëtarët e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), me temë: “Rritja e sigurisë publike dhe asaj në komunitet përmes bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor”.

Në këtë takim ishin përfaqësues dhe drejtues të institucioneve shtetërore, të komuniteteve fetare, organizata të shoqërisë civile, etj. Myftinia Shkodër u përfaqësua nga teologu Arben Halluni, i cili në fjalën e tij vlerësoi këtë takim dhe takimet e mëparshme, të cilat faktorizojnë rolin e të gjithë aktorëve për të përballuar sfidat e sigurisë publike në qytet, sidomos pas ngjarjeve të fundit kriminale, të cilat kanë tronditur mbarë qytetarët e Shkodrës e më tej.

Në fokus të këtij takimi, ishin edhe problematikat e konstatuara dhe gjetja e rrugëve të zgjidhjes, si dhe u diskutua për një plan të qëndrueshëm veprimi të KVSP-së dhe hapat e ardhshme.

MYFTIU I SHKODRËS TAKOI NXËNËSIT E QENDRËS SË MEMORIZIMIT TË KUR'ANIT, PRANË MEDRESESË "HAXHI SHEH SHAMIA"

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2022-2023, mbrëmjen e së hënës, më 26 shtator 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim me nxënësit e Qendrës së Memorizimit të Kur'anit, pranë Medresesë së Shkodrës.

Pas namazit të akshamit, Myftiu dha disa këshilla për nxënësit e përkushtuar, të cilëve iu drejtua me fjalë zemre, duke i përgëzuar për këtë mirësi të madhe dhe këtë rrugëtim të mrekullueshëm.

Në krye të herës, Myftiu shprehu mirënjohje dhe falënderim për Hoxhën e nderuar Osman ef. Nuri Topbash dhe stafin e tij, për kontributin e spikatur në mbështetje të institucioneve arsimore, veçanërisht në Shkodër.

Në fjalën e tij, Myftiu theksoi se qendra e Memorizimit të Kur'anit Famëlartë, është burim bekimesh dhe sigurie për Shkodrën, si dhe një investim i pallogaritur, në rrugën e ruajtjes së traditës, besimit dhe të ardhmes islame në këtë tokë.

Myftiu këshilloi hafizët e rinj për shfrytëzimin e kohës, për kontrollimin e zemrës dhe angazhimin me një vird dhikri ditor, në këtë mision të lartë që kanë marrë mbi supe, ata, familjet dhe kujdestarët e tyre, të cilët i falënderoi përzemërsisht.

Në krye të herës, mexhlisi nisi me një Fatiha për shpirtin e dijetarit të shquar të këtij shekulli, Dr. Jusuf El-Karadavi, që ndrroi jetë ditën e djeshme në Doha të Katarit, në moshën 96 vjeçare.

SHEMBULLI I BESIMTARIT TË MIRË, QË PUNON ME PËRKUSHTIM..!

SPITALI RAJONAL SHKODER

Shërbimi i Mjekësisë së Përgjithshme ndjek dhe kuron pacientët që vuajnë nga çrregullimet hepatologjike, autoimune, alergologjike, gastroenterologjike, reumatologjike dhe të gjitha problemet e tjera të mjekësisë interne.

Së fundmi znj.Lavdije Elezi ka marrë pozicionin e kryeinfermieres të këtij shërbimi ku ka punuar më shumë se vite. Ajo jep shembullin e punës së palodhur dhe me përkushtim ndaj pacientëve që kanë nevojë për këtë shërbim kaq kompleks.

MEJTEPI I IM... XHAMIA E LAGJES TEPE

Pak histori:

- Xhamia Tepe, ndodhet në Njësinë Administrative të Qytetit të Shkodrës, dhe është në një nga lagjet më të vjetra të qytetit me të njëjtin emërtim, Tepe.

- Aktualisht, përbëhet prej rreth 250 familje myslimane.

- Familjet më të njohura janë: Dushi, Lohja, Bega, Troshani, Xhafa, Hoxha, Hysa, Kraja, etj.

- Xhamia e re e Tepes është ndërtuar në vitin 2002, në themelet e xhamisë së parë në vendin vakëf, me kontributin e banorëve të lagjes Tepe dhe të shoqatës "Islamic Relief".

- Imamët dhe mësuesit e mejtepeve

Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi më 10 shtator 2022 një takim me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Tepe.

Teologu Halluni, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri të mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqiplotë.

Në fund të takimit, fëmijët e mejtepit u qerasen me asortimente të ndryshme ëmbëlsirash.

Në këtë takim ishte edhe mësuesi i mejtepit, z. Mirjan Peraj.

që kanë shërbyer në këtë xhami pas hapjes së xhamisë, nga viti 2002 e në vazhdim janë: Ilir Bejtja, Bashkim Bajraktari, Ridvan Luzaku, Ferdinand Mema, Ajdi Tollga dhe imami aktual Mirjan Peraj.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 15 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002-2022 është rreth 170 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Në kuadër të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë

SHEJKH JUSUF EL-KARADAVI
(Në mëshirën e Allahut)

Dr. Jusuf el-Karadavi
(9.9.1926 - 26.9.2022)

Dr. Jusuf Al-Karadavi lindi në një nga fshatrat e Republikës Arabe të Egjiptit, fshati Safët Turab, Njësia Mahal'la El-Kubra, prefektura El-Garbije, një fshat i lashtë në të cilin u varros i fundit nga sahabët në Egjipt, Abdullah ibnul-Harith ibn Xhuz Ez-Zubejdi, siç e ka thënë El-Hafidh ibn Haxheri dhe të tjerët.

Shejkh El-Karadavi lindi, më 9 shtator 1926. Rreth moshës 10 vjeçare mësoi përmendësh Kur'anin Famëlartë dhe përsosi rregullat e leximit të tij (Texhvidit).

Mësimet fillore dhe të mesme i kreu në institutin e Ez'herit Sherif, duke qenë gjithmonë prej të parëve.

Pastaj, hyri në Fakultetin e Usulid-Din (Bazave të Fesë) në Universitetin e Ez'herit, nga ku u diplomua në vitin 1952-53, duke u renditur i pari ndër njëqind e tetëdhjetë studentët e atij viti.

Më pas, mori diplomë licencë për mësimdhënie nga Fakulteti i Gjuhës Arabe (në Ez'her) në vitin 1954, dhe u rendit i pari në mesin e 500 studentëve të diplomuar në tre fakultetet e Ez'herit Sherif.

Në vitin 1958 mori diplomë nga Instituti i Studimeve të Larta Arabe për Gjuhë dhe Letërsi.

Në vitin 1960, mbaroi studimet e larta, diplomë masteri në Departamentin e Shkencave Kur'anore dhe Sunetit nga Fakulteti i Usulid-Din.

Në vitin 1973, mori titullin Doktor (PhD) me rezultat Shkëlqyeshëm të Nivelin e Klasit të Parë, nga i njëjti Fakultet, me temën: "Zekati dhe ndikimi i tij në zgjidhjen e problemeve sociale".

Postet e tij zyrtare:

Dr. El-Karadavi shërbeu për një periudhë si hatib dhe ligjërues në xhami të ndryshme, pastaj u bë përgjegjës i Institutit të Imamëve në varësi të Ministrisë së Vakëfeve, Egjipt.

Më pas ai u transferua në Drejtorinë e Përgjithshme të Kulturës Islame në Ez'heri Sherif, për të qenë përgjegjës i botimeve të saj dhe nëpunës në Zyrën Teknike të Departamentit të Thirrjes (Davetit) dhe Udhëzimit.

Në vitin 1961, ai u emërua në shtetin e Katarit si dekan i Institutit të Mesëm Fetar, ku punoi për zhvillimin dhe vendosjen e tij mbi rregullat të forta, duke kombinuar mes të vjetrës së dobishme dhe të resë së saktë.

Në vitin 1973, themeloi fakultetet e Arsimit për Djem dhe Vajza, si bërthamë të Universitetit të Katarit, ku më pas u transferua atje për të themeluar dhe drejtuar Departamentin e Studimeve Islame.

Në vitin 1977, mori përsipër themelimin dhe dekanatin e Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame në Universitetin e Katarit, dhe qëndroi dekan i tij deri në fund të vitit akademik 1989-1990, siç u bë edhe drejtuesi themelues i Qendrës Kërkimore të Sunetit dhe Historisë Profetike në Universitetin e Katarit.

U dërgua nga Shteti i Katarit për në Republikën simotër të Algjerisë, në vitin akademik 1990-1991 për të udhëhequr këshillat shkencorë të universiteteve dhe instituteve të larta islame në Algjeri, pastaj u kthye në punën e tij në Katar, si drejtor i Qendrës Kërkimore të Sunetit dhe Historisë Profetike.

Është nderuar me Çmimin e Bankës Islame për Zhvillim në Ekonominë Islame në vitin 1411 H.

Ka marrë Çmimin Ndërkombëtar 'Mbret Fejsal' në Studimet Islame në vitin 1413 H.

Ka marrë çmimin e Kërkuesit të Shquar Shkencor nga Presidenti i Universitetit Ndërkombëtar Islam në Malajzi, në vitin 1996.

Gjithashtu, ka marrë çmimin 'Sulltan Hasan El-Bulkije' (Sulltan i Bruneit) në Fikhun (Jurisprudencën) Islame, në vitin 1997.

Botimet e tij:

Shejh Jusuf El-Karadavi, një nga figurat e shquara të Islamit në epokën e sotme në shkencë, mendim, thirrje dhe ixhtihad, në botën islame, në lindje dhe në perëndim të saj.

Nuk ka musliman bashkëkohor që nuk e ka takuar atë, duke lexuar një libër, një mesazh, një artikull, një fetva, apo duke dëgjuar një ligjëratë, hytbe, ders, histori apo përgjigjeje, në një xhami, universitet, qendër, radio, televizion, ose kasetë apo diçka tjetër.

Veprimtaria e tij në shërbim të Islamit nuk kufizohet në një aspekt, në një fushë të caktuar, apo me një ngjyresë të veçantë, por veprimtaria e tij ishte e gjerë, aspektet e saj qenë të shumëllojshme, dhe fushat e tij ishin të shumta, ku në secilën prej tyre la gjurmë të qarta, që tregojnë dhe i referohen atij.

Shejh Jusuf El-Karadavi ka shkruar qindra libra, mesazhe dhe shumë fetva, dhe ka regjistruar shumë episode me programe fetare, duke përfshirë dokumentarë dhe emisione të drejtpërdrejta.

Disa prej librave të tij:

1. *Hallalli dhe harami*
2. *Fetva bashkëkohore*
3. *Tejsir El-fikh lil-muslim el-muasir*
4. *Tejsir fikhus-sijam*
5. *Fikhul-lehv vet-tervih*
6. *El-Ixhtihad fish-sheriati el-islamije*
7. *El-Med'hal li diraseti esh-sheriati el-islamijeti*
8. *Min fikh ed-devleti fil-Islam*
9. *El-Fetva bejnel-indibat vet-tesejjub*
10. *Fi fikh el-akl'lijat el-muslimeti*
11. *Fikhuz-Zekat*
12. *Fevaid el-bunuk hije er-riba el-haram*
13. *Duver ez-zekat fi ilaxh el-mushkilat el-iktisadijeti ve shurut nexhahiha*
14. *Kejfe neteamelu meal-Kur'an el-adhim*
15. *El-Hajat er-rebbanije vel-ilm*
16. *En-Nijetu vel-ihlas*
17. *El-Ihvan el-muslimun seb'une amen fid-daveti vet-terbijeti vel-xhihad*
18. *El-Vakt fi hajatil-muslim*
19. *Es-Sahvetu el-islamijetu ve humumul-vatan el-arabij vel-islamij*
20. *Uluvijat el-hareketi el-islamijeti fil-merhaleti el-kadimeti*

Etj.

Xhamia e Plumbit

(E ndërtuar nga Mehmet Pashë Bushati në vitin 1773)

Foto e vjetër e lagjes Tabake, Shkodër

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek